

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 9

(Janar– Qershor 2021)

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	4
1. Vendim nr.16, datë 16.03.2021	4
2. Vendim nr. 278, datë 12.05.2021	9
3. Vendim nr.80-2021-743, datë 17.03.2021.....	11
4. Vendim nr. 167, datë 11.03.2021	15
5. Vendim nr.286, datë 25.05.2021	18
6. Vendim nr. 1080, datë 23.12.2020	20
7. Vendim nr. 267, datë 12.05.2021	22
8. Vendim nr.269, datë 12.05.2021	24

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://ëëë.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në faqen legjislacionin, në linkun: <https://ëëë.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr.16, datë 16.03.2021

Gjykata Kushtetuese

Kërkues: Shoqëria “G” sh.p.k;

Subjekte të Interesuara: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Avokatura e Shtetit

Objekti: “Shfuqizimi i vendimit Nr. 00-2017-1692, datë 26.09.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”

Shuma e detyrimit tatimor: Gjoha dhe kamatëvonesa për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që i përkasin periudhës deri më datën 31.12.2010 në shumën 17.862.006 lekë

Baza Ligjore:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. *Ligji nr.8577/2000*), neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*).
3. Ligji nr.8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
4. Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së”, i ndryshuar,
5. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar,
6. Ligji nr.9136 dt.11.09.2003 për “Për mbledhjen e Kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
7. Udhëzimi nr.26 dt.16.04.2009 “Për mbledhjen e Kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore”, i ndryshuar,

Përmbledhje e Fakteve:

Kërkuesja është një shoqëri tregtare, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e prodhimit dhe përpunimit të këpucëve. Ajo i është drejtuar organit tatimor me një kërkesë për të përfitur nga amnistia fiskale për faljen e gjobave dhe te kamatëvonesave për kontributet e sigurimeve shoqërore

dhe shëndetësore, bazuar në ligjin nr.10418 datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder e ka njoftuar kërkuesen se nuk i plotëson kushtet për të përfituar nga amnistia fiskale.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është zhvilluar gjykimi i çështjes gjyqësore me palë paditëse Shoqërinë “C” sh.p.k, e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe me objekt gjykimi “detyrimin e të paditurit të njohë faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që i përkasin periudhës deri më datën 31.12.2010 në shumën 17.862.006 lekë”.

Ligji nr.10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.51 date 3 maj 2011.

Neni 35 i këtij ligji në atë periudhë shprehte “**kohën e zbatimit**” të tij si më poshtë : *e drejta e subjekteve, që të përfitojnë nga legalizimi dhe falja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të ushtrohet deri në datën 31 mars 2012.*

Ky ligj është ndryshuar me Ligjin nr.154/2013, datë 30.05.2013, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 95, datë 07.06.2013.

Neni 35 i këtij ligji shpreh “Kohën e zbatimit”:

E drejta e subjekteve që të përfitojnë nga legalizimi dhe falja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar me Ligj nr.154/2013, dt 30.05.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 95, dt 07.06.2013.)

Ligji nr.10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi Nr 12, datë 18.05.2011 për zbatimin e tij, i ndryshuar kishte përcaktuar një procedurë të caktuar për të operuar dhe afate ligjore për zbatim për subjektet dhe për organin administrativ tatimor.

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Tiranë datë 16.06.2011 “Mbi zbatimin e këtij ligji...” përcaktonte një procedurë të caktuar për zbatimin e këtij ligji.

Subjekti paditës nuk është vlerësuar si përfitues për këto vlera detyrimi, pasi në nenin 18 të ligjit nr.10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” shprehej :

1.Nga **falja e parashikuar në këtë kre** përfitojnë :

a)të gjithë tatimpaguesit, ndaj të cilëve **administratat tatimore nuk kanë detyrime për rimbursim të shumave**, pavarësisht nga shkakut i këtij rimbursimi apo **kreditim të tatimeve** si dhe kur **nuk rezultojnë me tepricë kreditore** ndaj administratës tatimore.

b)të gjithë tatimpaguesit, ndaj të cilëve administratat tatimore kanë detyrime për rimbursim të shumave apo kreditim të tatimeve ose që rezultojnë me tepricë kreditore, *në rastet kur pranojnë me shkrim*, që shumat për tu rimbursuar apo për tu kredituar nga administrata tatimore të zvogëlohet në vlerë të barabartë me shumën e detyrimit tatimor të falur.

Dispozita ligjore, neni 18 pika 1 shpreh **“nga falja e parashikuar në këtë Kre”**, ku në vijim renditen dispozitat e tjera të këtij Kreu, ndër to dhe neni 23, 24...

Subjektit i është kthyer një përgjigje shkresore nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me nr. _____ prot., datë 08.06.2012, nëpërmjet së cilës bëhet i ditur qëndrimi i këtij organi në lidhje me faljen e detyrimeve, referuar kërkesës së tij protokolluar me nr. _____ prot datë 24.05.2012.

Subjekti ka rezultuar me gjendje kreditore në T.V.SH (tatimin mbi vlerën e shtuar) në vlerën prej 26.133.999 lekë (sipas përgjigjes në atë periudhë) për periudhën tatimore 2011/04. Në Udhëzimin Nr 12 datë 18.05.2011 për zbatimin e këtij Pika II. **“Falja e detyrimeve tatimore dhe doganore”** shprehej:

1. Në zbatim të germës “b” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit, administrata tatimore zvogëlon shumën e detyrimit tatimor bazuar në kërkesën e tatimpaguesit në masën e kredisë apo kredisë së rimbursueshme, **duke respektuar kriteret e kompensimit të detyrimeve.**

Në rastet kur rezulton detyrim i pambuluar nga kompensimi i aplikuar, për pjesën e mbetur procedohet sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj.

Subjekti i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve me një kërkesë, protokolluar nr. _____ prot datë 26.10.2011 (16 fletë) “për kompensim nga teprica kreditore” në t.v.sh dhe tatim fitim, e cila është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Vlerësimit Tatimor, e cila ka mbajtur Akt konstatimin nr.9188/1 prot datë 27.10.2012 për kompensimin e kryer, aq sa ishte e mundur, lejuar.

Subjekti i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve me një kërkesë, protokolluar nr. _____ prot datë 25.01.2012 “për kompensim nga teprica kreditore” për tepricën në kontribute të sigurimeve shoqërore, e cila është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Vlerësimit Tatimor, e cila në vijim ka mbajtur Akt konstatimin nr. _____ prot., datë 02.02.2012 për kompensimin e kryer.

Subjekti ka rezultuar përsëri me gjendje kreditore në T.V.SH (tatimin mbi vlerën e shtuar) në vlerën prej 26.133.999 lekë (në atë periudhë) për periudhën tatimore 2011/04, vazhdonte me tepricë kreditore.

Shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore ose shëndetësore (detyrim kontributiv) e paguar më tepër nuk mund të kalohet për mbulimin e detyrimeve, interesave dhe gjobave të papaguara të tatimeve të tjera.

Kredia e rimbursueshme e tatimeve të tjera mund të përdoret për të mbuluar gjobat e inspektorëve të vendosura për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, **por nuk mund të përdoret për të mbuluar detyrimet ose interesat e papaguara të kontributeve.**

➤ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.1249 datë 21.05.2013, nëpërmjet të cilit vendosi :

- *Pranimin e kërkesë-padisë*

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër i është drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër me një ankim ndaj vendimit nr.1249 datë 21.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, akti shkresor nr.____ prot., datë 03.06.2013.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr.249 datë 16.01.2014 ka shpallur moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes duke dërguar aktet për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

➤ Gjykata Administrative e Apelit, pasi shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi me vendimin e saj nr.801 datë 18.03.2014 në lidhje me çështjen vendosi :

- *Ndryshimin e vendimit nr.1249 datë 21.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e padisë.*

Në lidhje me këtë vendim ka paraqitur Rekurs Shoqëria “C” sh.p.k.

➤ Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin e tij Nr.00-2017-1692 datë 26.09.2017 në lidhje me rekursin e paraqitur nga shoqëria ka vendosur:

- *Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Shoqëria ndaj vendimit nr.801 datë 18.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*

Subjekti tashmë më emërtimin Shoqëria “G” sh.p.k i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar “Shfuqizimi i vendimit Nr. 00-2017-1692, datë 26.09.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

➤ Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj Nr.16 datë 16.03.2021 vendosi :

- *Pranimin pjesërisht të kërkesës*
- *Konstatimin e gjykimit tej afatit ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë*

Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga subjekti në kërkesën e tij adresuar Gjykatës Kushtetuese ai pretendonte, se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60, pika 2 e ligjit nr.49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit nga gjykata ku ai është depozituar. Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesën për konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ka theksuar, se arsyeshmeria e zgjatjes së procesit duhet të vleresohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve si dhe rrezikun që passjell për kërkesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.

Sipas vendimit të Gj.K, vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë pasi kanë kaluar 3 vjet nga regjistrimi i çështjes.

Gjykata konstaton, se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr.49/2012. Gjykata verën, se çështja konkrete nuk

paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkueses është me rëndësi në këtë kontekst.

Gjykata çmon se çështja në Gjykatën e Lartë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi kjo e fundit ka marrë vendim për çështjen 3 vjet pas regjistrimit të saj, ç'ka në raport me afatin ligjor 90- ditor është një kohëzgjatje e paarsyeshme. Për pasojë pretendimi i kërkueses për cënimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm është i bazuar.

❖ Subjekti në kërkesën e tij adresuar Gjykatës Kushtetuese pretendonte dhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmerinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Për me tepër ligji nr.49/2012 në nenin 61 ka përcaktuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi dhe në nenin 62 ka parashikuar, se cilat janë përjashtimisht rastet e shqyrtimit të çështjes në seance gjyqësore me praninë e paleve.

Nga ana tjetër përsa i përket arsytimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar, se nuk përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsytim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsytimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar, se Gjykata e Lartë në përputhje me kompetencat e saj ligjore ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe i ka dhënë përgjigje kërkueses se pretendimet e saj nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr.49/2012. Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi ka ushtruar në këtë rast funksionin e saj seleksionues duke vlerësuar paraprakisht, nëse kërkesa i plotësonte kërkesat e ligjit për kalimin në seancë. Edhe pse me një arsytim të kufizuar ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e mësipërme të arsytimit në dhomën e këshillimit.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se pretendimi i kërkuesit për cënimin e standardit të arsytimit, i lidhur me të drejtën për akses në gjykatë dhe të drejtën e ankimit substancial është i pabazuar.

Gjykata çmoi, se në rastin konkret është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 60, pika 2 i ligjit nr. 49/2012.

Vendimi i Gjykatës:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Konstatimin e gjykimit tej afatit ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë .

2. Vendim nr. 278, datë 12.05.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Padites: Shoqëria “D.K” sh.p.k.

I paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria e Apelit Tatimor
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Kontrollit Tatimor

Objekti: 1. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit e DRT Tiranë me nr.____, datë 07.07.2016 marrë me postë në datën 08.07.2016;
2.Shfuqizimin e Vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr.____, datë 03.11.2016 marrë me postë në datën 04.11.2016

Shuma e detyrimit tatimor: 1 686 655 Lekë.

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurave Civile nenet 41, 43, 328, 331/3/4.
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 32, 33 68, 69, 70, 80, 81, 109, 127.
3. Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin mbi te Ardhurat“, neni 21

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqëria “D.K” shpk është kontrolluar nga DRT Tiranë, në zbatim të njoftim kontrollit nr.____ prot, datë ____ dhe programin e kontrollit bashkëlidhur tij për periudhat tatimore:

- “Për TVSH-në” periudha 01.09.2013 - 31.12.2015;
- “Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore” 01.09.2013 - 31.12.2015;
- “Tatimi mbi fitimin” 2013 dhe 2014.

Në përfundim të kontrollit, është mbajtur raporti i kontrollit ku janë përshkruar shkeljet e konstatuara gjatë tij. Nga kontrolli i pasqyrave financiare të vitit 2014 është konstatuar se kosto e mallrave të shitur në bilanc është në shumën 78.077.167 Lekë, e cila përbëhet nga kosto e mallrave të shitur për shitjet me faturë tatimore në shumën 66.832.802 Lekë, e analizuar si më poshtë:

Gjendje fillim periudhe 45.360.694 Lekë;

Blerje gjatë periudhës 79.045.892 Lekë;

Gjendje fund periudhe 57.573.784 Lekë;

KMSH 66.832.802 Lekë.

Ndërkohë nga ana e shoqërisë është kaluar dhe në shpenzime, kosto e mallrave të rivlerësuar nga

ana e kontrollit të mëparshëm në shumën 11.244.365 Lekë, duke i ngarkuar pa të drejtë shpenzime për këtë shumë, e cila në zbatim të Ligjit nr.8438 dt.28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 21, nga ana e kontrollit do të klasifikohet shpenzim i panjohur dhe shoqërisë i lind një detyrim për tatimin mbi fitimin në shumën 1.685.655 Lekë.

Duke mos qenë dakord me këtë detyrim, shoqëria i është drejtuar me ankin administrativ, Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin e saj nr._____ prot., datë 3.011.2016 ka vendosur “Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr._____ prot., datë 7.07.2016 të DRT Tiranë”.

Kundër këtij vendimi, shoqëria ka ngritur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr.1236 dt.27.03.2017 ka vendosur:

- **“Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse Shoqëria “D.K” sh.p.k.”**

Kundër këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit nga ana e palës paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë por edhe në apel vërtetoi se shoqëria paditëse ka deklaruar në shpenzime dhe koston e mallrave të rivlerësuara nga kontrolli i mëparshëm në shumën 11.244.365 Lekë. Përfundimet e këtij kontrolli, finalizuar me njoftim vlerësimin e detyrimeve tatimore nr._____ prot., datë 05.11.2014 pala paditëse i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, i cili ka përfunduar pa zgjidhje përfundimtare. Pra, as në rrugë administrative dhe as në rrugë gjyqësore nuk është deklaruar i pavlefshëm/ i paligjshëm njoftim vlerësimi i detyrimeve tatimore nr._____ prot., datë 5.11.2014 nxjerrë nga DRT Tiranë. Ndërkohë në këtë gjykim, rezulton se po këtë vlerë (11.244.365), pala paditëse e ka përfshirë dhe në gjendjen e inventarit në fund të periudhës tatimore.

Referuar veprimeve të kryera në kontabilitet nga shoqëria, rezulton se vlera 11.244.365 lekë është përfshirë në koston e mallit të shitur gjatë periudhës, edhe në gjendjen inventari. Në këtë mënyrë nga ana e Shoqërisë “D.K” shpk janë dubluar veprimet kontabël, veprim i cili bie ndesh me të gjitha parimet e kontabilitetit. Në momentin kur një vlerë përcaktohet si kosto e mallit të shitur, nuk mund të jetë dhe gjendje inventari, pasi kosto e mallit të shitur nënkupton shpenzimet e kryera për një mall të shitur.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se grupi i kontrollit ka zbatuar të gjithë legjislacionin tatimor, duke mos shkaktuar mangësi të procedurës së kontrollit të relizuar.

Veprimet e palës paditëse janë të gabuara pasi nuk mund të kontabilizohet njëkohësisht dhe në shpenzime dhe në gjendje inventari e njëjta vlerë. Këto gabime kanë pasjellë dhe penalizimin me të drejtë të shoqërisë nga ana e administratës tatimore

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.1236, dt.27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Vendim nr.80-2021-743, datë 17.03.2021

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Padites: “U.E” shpk

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____prot., datë 23.07.2020 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për gjoba në vlerën totale 277.236 lekë.

Shfuqizimin e aktit administrative “Vendim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor” njoftuar me shkresën me nr. _____ prot., datë 26.10.2020, i cili ka lënë në fuqi njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ prot., datë 23.07.2020 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: 277.236 lekë;

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, nenet 7, 11, 15, 16, 17;
2. Ligji nr.9920, datë19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. Udhëzimi nr.24, dt.02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Permbledhje e Fakteve:

Paditësi “U.E” shpk me Nipt ____ është subjekt në administrimin e DRT Tiranë. Në rastin konkret nga punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, bazuar në urdhrin e punës nr.____ prot., datë 30.06.2020, është ushtruar kontroll në subjektin ‘U.E’ me Nipt ____ në adresën ‘Mjeti me targa ____’, me aktivitet ‘Shërbime postare’.

Shoqëria “U.E” është ngarkuar me detyrime tatimore nëpërmjet njoftim vlerësimit nr.____ prot., datë 23.07.2020. Vlerësimi tatimor është rrjedhë e akt-konstatimit me nr._____, datë 02.07.2020 dhe proçes-verbal gjobë me nr. _____, datë 02.07.2020. Sipas akt konstatimit rezulton se nga punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, bazuar në urdhrin e punës nr.____ prot., datë 30.06.2020 është ushtruar kontroll në subjektin ‘U.E’ me NIPT ____ në adresën “Mjeti me targa ____”. Sipas akt konstatimit nga kontrolli i kryer ka rezultuar se:

“Subjekti është i regjistruar në QKB dhe organin tatimor me Nipt _____ dhe nuk paraqiti dokumentacion për regjistrim adresë dytësore ose vërtetim nga organet tatimore për regjistrim të mjetit me targa _____. Subjekti në këtë adresë ushtron veprimtarinë e transportit.

Në punë u gjet F.U me ID _____ me pozicion shofer, i cili nuk është i deklaruar në organin tatimor. Subjekti nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton si në vijim:

1. Dyshek tek+jorgan sasia 2 në vlerën totale 40.000 lekë,
2. Jorgan sasia 1*5.100 lekë,
3. Shtrat shtange sasia 1*12.800 lekë,
4. Set çelësash mekanik 1*7.460 lekë
5. Amortizator mekanike 2 copë me vlerë totale 8.056 lekë. Vlera totale e mallrave 73.416 lekë.

Subjekti nuk disponon në vendbiznes dokumentacion tatimor, bllok 'Faturë tatimore shitje', për të kryer autofaturën për mallrat e pashoqëruar me dokumentacion tatimor.”

Si rrjedhojë me proces-verbal gjobë me nr. _____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mospërditësimin e të dhënave për mjetin me targa _____, në shumën 15.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 i ndryshuar, neni 112.

Me proces-verbal gjobë me nr._____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për punëmarrës të padeklaruar, në shumën 200.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma a).

Me proces-verbalin gjobë me nr._____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë tvsh për mallrat e padokumentuara me faturë tatimore në shumën 12.236 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 I ndryshuar, neni 124, pika 1.

Me proces-verbalin gjobë me nr.294800, dt.02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mosmbajtje dokumentacioni (bllokun e faturave), në shumën 50.000 lekë, bazuar në ligjin nr.9920/2008 I ndryshuar, neni 118, njoftuar me njoftim vlerësimin e sipërcituar.

Shoqërisa “U.E”shpk ka kundërshtuar gjobat e vendosura duke bërë ankim administrativ tek Drejtoria e Apelimit Tatimor. Drejtoria e Apelimit Tatimor pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, ka vendosur me vendimin me nr._____ prot., datë 26.10.2020, duke lënë në fuqi të aktit administrative njoftim vlerësimi me nr.____ prot., datë 23.07.2020. Duke e konsideruar vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor të pambështetur në prova dhe ligj, tatimpaguesi “U.E” shpk i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata çmon se aktet administrative objekt gjykimi janë nxjerrë nga ana e organit administrative pasi strukturat përkthënë të administratës tatimore konform atributëve që u njeh ligji kanë ushtruar kontroll. Gjatë këtij kontrolli kanë ndëshkuar palën paditëse sepse gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij janë konstatuar kundravajtje administrative, si rrjedhojë me proces-verbal gjobë me nr.294797, dt.02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mospërditësimin e të dhënave për mjetin me targa _____, në shumën 15.000 lekë, bazuar në ligjin 9920/2008 i ndryshuar, neni 112, me proces-verbal gjobë nr. _____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën 200.000 lekë bazuar në nenin 119, pika 1, germa a), me proces-verbal gjobë me nr. ____, datë 02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë TVSH për mallrat e padokumentuara me faturë tatimore, në shumën 12.236 lekë bazuar në nenin 124, pika 1, me proces-verbal gjobë me nr.____, dt.02.07.2020 tatimpaguesi është sanksionuar me gjobë për mosmbajtje dokumentacioni (bllokun e faturave) në shumën 50.000 lekë bazuar në nenin 118. Të

gjitha detyrimet e mësipërme - janë njoftuar me njoftim vlerësimin me nr. ____ prot., datë 23.07.2020 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Lidhur me sanksionimin me gjobë për mospërditësimin e të dhënave të QKB në shumën 15.000 lekë gjykata analizon dhe vlerëson se detyrimi i tatimpaguesit për deklarimin dhe përditësimin e të dhënave, përfshirë edhe mjetin buron nga neni 43 i ligjit nr.9920/2008. Pika 43.4.3 i udhëzimit nr.24/2008 parashikon se “për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i lëvizjes së të cilëve është shitja derë më derë, mjetet e transportit të mallrave si dhe mjetet e transportit të udhëtarëve që I përkasin personave të regjistruar për kryerje aktiviteti transporti mallrash apo udhëtarësh duke u konsideruar adresa ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij si dokument vërtetues i përkatësisë së mjetit është çertifikata e regjistrimit të personit të tatueshëm me numër të ndryshëm serial e lëshuar për cdo mjet që kryen veprimtari në të tilla kushte”. Paditësi nuk arriti të provonte se në momentin e kontrollit nga grupi i kontrollit tatimor në datën 02.07.2020 mjeti me targa ____ku është ushtruar kontrolli ka qënë i pajisur me dokumentacionin e duhur sipas përcaktimeve në pikën 43.4 t udhëzimit nr.24/2008. Për rrjedhojë gjykata vlerëson se penalizimi me gjobë prej 15.000 lekë është i drejtë, është i ligjshëm e për pasojë duhet lënë në fuqi.

Lidhur me sanksionimin me gjobë për punëmarrës të padeklaruar gjykata arsyeton se nëpërmjet dënimeve ligjvënësi ka patur për qëllim detyrimin e tatimpaguesve që të deklarojnë punëmarrësit e tyre pranë organeve tatimore përpara fillimit të punës dhe më tej të llogarisin, mbajnë dhe derdhin pranë buxhetit të shtetit kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Dënimi me gjobë sipas përcaktimeve në nenin 119, për cdo punonjës të padeklaruar, vendoset në kushtet e flagrancës kur gjatë kontrolleve të ushtruara në ambientet ku ushtron aktivitetin konstatohet që ky i fundit nuk ka deklaruar përpara kontrollit punëmarrësin e ri. Pala paditëse ka patur detyrimin për deklarimin dhe përfshirjen në skemën e kontributeve në përputhje me sa është përcaktuar në dispozitat në fuqi. Pala paditëse nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor për punonjësin e konstatuar në punë në momentin e kontrollit e për rrjedhojë sanksionimi me gjobë në shumën 200.000 lekë sipas nenit 119 pika 1 germa a) vlerësohet i drejtë e për pasojë duhet lënë në fuqi.

Lidhur me gjobën e TVSH për mallrat e padokumentuar me faturë tatimore në shumën 12.236 lekë bazuar në neni 124, pika 1 të ligjit 9920/2008, gjykata analizon se bazuar në neni 121, pika 1 germa (b) i ligjit 9920/2008 paditësi ka detyrimin ligjor që për mallrat në ruajtje, përdorim ose transport duhet t'i ketë të shoqëruara me faturë tatimore. Referuar akt-konstatimit nr.____, datë.02.07.2020 subjekti në mjetin me targa ____nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton. Gjkata konstaton faktin se referuar akt kontrollit, kontrolli është ushtruar në subjektin “U.E” i cili kishte në ruajtje dhe transportonte mallra të pashoqëruara me dokumentacionin tatimor përkatës. Pika 50.7 i udhëzimit 24/2008 parashikon se kur transporti i mallrave kryhet nga palë të treta lëvizja e mallit shoqërohet me faturën e shitjes së mallit, ku ka të dhëna edhe për transportuesin dhe datën e transportit. Për mallrat e pashoqëruara me faturë tatimore subjekti detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore sipas nenit 53, të ligjit 9920/2008 dhe mallit I kryhet rivlerësim I shitjeve në të njëjtin vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim sipas pikës 1 të nenit 124 të ligjit 9920/2008. Pala paditëse nuk e ka përmbushur këtë detyrim dhe për pasojë sanksionimi me gjobë vlerësohet i drejtë.

Lidhur me sanksionimin me gjobë për mosmbajtje dokumentacioni në vendbiznes në shumën 50.000

lekë referuar akt konstatimit me nr.____, datë 02.07.2020 shoqëria nuk disponon dokumentacionin tatimor bllok me tvsh për të dokumentuar mallin pa dokumentacion për të cilën është mbajtur dhe process-verbal gjobë me nr.____, datë 02.07.2020. Nga kontrolli dhe verifikimi në vend është konstatuar se nuk është përmbushur detyrimi ligjor lidhur me mbajtjen e dokumentacionit tatimor dhe transportimi i mallit të pashoqëruar me dokumentacion tatimor për rrjedhojë gjykata vlerëson se me të drejtë paditësi është sanksionuar me gjobë.

Gjykata në analizë të kuadrit ligjor si më sipër konstaton se nga ana e palës së paditur janë nxjerrë akte administrative të ligjshme të cilat pasqyrojnë gjendjen faktike, e cila u riprodhua para gjykatës nëpërmjet provave të analizuara. Për pasojë penalizimi i paditësit nëpërmjet aktit administrativ objekt gjykimi është i ligjshëm dhe si i tillë duhet lënë në fuqi. Kjo pasi gjatë kontrollit ka rezultuar se paditësi ushtron aktivitet ekonomik dhe nuk ka bërë përditësim për mjetin me targa ____, është konstatuar në punë shtetasi F.U me pozicion shofer, i cili nuk është i deklaruar në organin tatimor, nuk disponon dokumentacion tatimor për mallrat që i ruan dhe transporton, vlera totale e mallrave prej 73.416 lekë si dhe nuk disponon në vendbiznes dokumentacion tatimor, bllok “Faturë tatimore shitje”për të kryer autofaturën për mallrat e pashoqëruar me dokumentacion tatimor. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e rrëzon padinë dhe e konsideron të drejtë dënimin e palës paditëse

Vendimi i Gjykatës:

-Rrëzimin e kërkesë-padisë.

4. Vendim nr. 167, datë 11.03.2021

Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë

Paditës: Shoqëria “A”

Të paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM)

Objekti: Shfuqizimi i aktit administrativ nr. ____ datë 30.01.2018 të DTM-së. Detyrimi i DTM-së të shuajë detyrimet tatimore sipas kërkesës së PIA-së.

Shuma e detyrimit tatimor: 1.300.000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 33 datë 30.03.2017 “Për pagesën dhe shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme doganore si dhe procedure e heqjes dorë nga qarkullimi i mjeteve të transportit pas shuarjes fshirjes së detyrimeve”.
2. Ligji nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”,

Rrethanat dhe Faktet

1. Shoqëria “A” i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për shfuqizim akti administrativ nr. ____ datë 30.01.2018 e cila është një kthim përgjigje që DTM i ka bërë subjektit në bazë të shkresës nr. ____ datë 28.12.2017 të dërguar nga shoqëria.

Nga ana e DTM-së në këtë shkresë objekt padie i kthejmë përgjigje subjektit duke e sqaruar si më poshte vijon: “Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për shuarjen e penaliteteve në sistemin tatimor, ju informojme se kerkesat tuaja nuk përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 të Ligjit nr.33/2017: “***Detyrimet doganore tatimore që janë në proces ankimi***”.

Subjekti, i cili është në proces ankimi administrativ, ose gjyqësor për detyrimet tatimore i nënshtrohet këtij ligji nëse ai heq dorë nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo faze dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

Shoqëria nuk ka përfituar nga ligji i faljes për shkak se heqja dorë nga procesi i ankimit gjyqësor i paraqitur nga ana e shoqërisë i referohet një procesi gjyqësor i cili rezulton i mbyllur me vendim gjyqësor te forms se prere dhe detyrimi që ju kërkoni t’ju fshihet nuk ka të bëjë me procesin gjyqësor me të cilin ju bëni heqjen dorë.

2- Pretendimi dytë i shoqërisë për vlerën 932.000 lekë të përfshirë në Njoftim Vlerësimin nr. _____, datë 30.04.2012.

Për këtë Njoftim Vlerësimi shoqëria “A” ka ngritur padi në Gjykatë.

Me vendimin nr. 4001 datë 11.07.2014 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjithashtu dhe Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë. Pala paditëse mbasi ka dalë vendimi i Gjykatës së Apelit ka paguar detyrimin por e ka paguar pjesërisht në vlerën 3.422.466 lekë dhe nga kjo vlerë ka ngelur pa paguar 932.000 leke.

Për këtë proces gjyqësor shoqëria ka bërë kërkesë për heqje dore nga e drejta e ankimit por kërkesa është e depozituar në gjykatën jokompetente.

Në këto kushte nuk ka vendim nga ana e Gjykatës për pushim të procesit gjyqësor me kërkesë të “A”, ndaj dhe DTM nuk mund të bënte faljen e kësaj shume. Pasi procesi gjyqësor vazhdon dhe do kemi dhe një vendim për këtë shumë edhe pse për shkaqe procedurale shoqëria nuk mund të përfitonte nga Ligji i faljes pasi nuk rezulton që të ketë hequr dorë nga procesi.

3- Pretendimi i tretë i shoqërisë për vlerën 990.326 lekë të përfshirë në Njoftim Vlerësimin nr. _____ datë 13.09.2013. Ky Njoftim Vlerësimi ka qene ne proces gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padise dhe ndaj këtij vendimi shoqëria “A” ka bërë ankim.

Pala paditëse depoziton kërkesën për heqjen dore nga ankimi me datë 07.12.2017 por sërish në Gjykatën e gabuar në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe jo në Gjykatën e Apelit.

Në këtë rast është gabim procedural i shoqërisë deri sa për shkak të kësaj ngatërrese nuk kemi një Vendim nga ana e Gjykatës në të cilën ndodhet dosja për shqyrtim atëherë rezulton se çështja është ende në proces. Në këto kushte, DTM nuk mund të perfshinte këtë shumë në Ligjin e faljes pasi nuk është plotësuar kushti që parashikon Ligji nr.33/2017 neni 11 pika 1.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Administrative e Apelit me vendimin nr.167 dt.11.03.2021 ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke arsyetuar si më poshtë vijon:

Pala paditëse nuk plotëson kushtet për të përfituar nga ligji i faljes pasi nuk ka hequr dorë nga e drejta e padisë pasi rekursin e ka ushtruar i padituri i cili ishte gjyqumbës në atë proces e në këto kushte nuk plotësohen kërkesat e ligjit nr.33/2017, pasi paditësi sipas nenit 11 të ligjit do të duhej të hiqte dore nga e drejta e padise per detyrimet e perfshira ne Njoftim Vleresimin nr._____.

2-Me vendimin nr. 5741 dt.16.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë. Në këtë vendim objekt shqyrtimi ka qenë Njoftim Vlerësimi nr. _____, datë 13.09.2013. Ky vendim rezulton të këtë marr formë të prerë. Pala paditëse ka ushtruar të drejten e ankimit me datë 31.10.2014. Referuar Ligjit nr.33/2017 me datë 27.12.2017 paditësi ka depozituar një kërkesë për heqje dore nga ankimi pranë Gjykatës administrative të Shkallës së Parë, duke u

shprehur se në Gjykatën e Apelit po shqyrtohet kjo çështje e se heqin dorë nga ankimi. Rezulton se ky vendimi i sipërcituar ka marrë formë të prerë dhe pala paditese nuk provoi se ky ankim i pretenduar ndaj këtij vendimi të jetë regjistruar në gjykatë pavarësisht se kërkesë për heqje dore nga ankimi është depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Pala paditëse nuk provoi se çfarë ishte bërë me çështjen. Ndaj këtij vendimi nuk u provua që pala paditëse të jete ne kushtet të përfitoje nga Ligji nr.33/2017.

3- Për detyrimet e perfshira në Njoftim Vlerësimin nr._____, datë 30.01.2012 paditësi ka hequr dorë nga e drejta e ankimit e vendimit gjyqësor nr. 4001 datë 11.07.2014, kjo kërkesë është depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në përmbajtje të së cilës thuhet se heqin dorë nga e drejta e ankimit për çështjen që ka përfunduar në Gjykatën e Apelit e ndaj të cilës nuk është ushtruar ankim. Në këtë rast shoqëria DTM ka vepruar drejt duke ju drejtuar palës paditëse me shkresen nr.____ datë 30.01.2018 duke refuzuar fshirjen e detyrimeve pasi shoqëria nuk perfiton nga ligji nr.33/2017 referuar nenit 11 pika 1.

Vendimi i Gjykatës:

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Vendim nr.286, datë 25.05.2021

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: “K” shpk

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

Objekti: Pavlefshmëri Absolute të Akteve Administrative Njoftim Vlerësimi Nr. _____ Prot datë 12.12.2012 dhe Njoftim Vlerësimi Nr. _____ Prot., datë 29.10.2013, Njoftim Vlerësimi Nr. _____ Prot., datë 04.11.2013, të DRT Durrës.

Shuma e detyrimit tatimor: 159,391,839 lekë

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurave Civile nenet 154 e vijues;
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. Kodi i Procedurave Administrative nenet 105, 115/a, 116 e vijues;

Rrethanat dhe Faktet

Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, ka ushtruar kontroll pranë shoqërisë, për zërat Tatim fitimi për vitin 2007, 2008,2009, 2010,2011, për TVSH për periudhën 01.05.2007-01.05.2012. Rezulton se në përfundim të kontrollit, me shkresën nr. _____prot., datë 12.12.2012 është dërguar Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore, së bashku me raport kontrollin tatimor, sipas të cilit shoqëria “K” shpk detyrohet të paguajë të gjithë detyrimin e rivlerësuar në shumën 93.918.114 lekë. Shoqëria “K” shpk ka bërë kundërshtimin e raportit të kontrollit nëpërmjet obsevacionit, duke kërkuar pranë DPT, rikontroll të periudhave tatimore. Edhe rikontrolli i kryer nga DRT Durrës, ka vendosur lënien në fuqi të detyrimeve tatimore të njoftuara tashmë me aktin e kontrollit të parë, duke shtuar madje detyrime të tjera në masën 891.269 lekë, të konstatuara gjatë rikontrollit, dhe të njoftuara me aktin administrativ Njoftim Vlerësimi Nr. _____ datë 29.10.2013.

Në lidhje me Aktin Administrativ Nr. _____ Prot., datë 04.11.2013, rezulton se më datë 30.10.2013 është ushtruar një kontroll tematik në subjektin “K” shpk, me objekt: Verifikimi i saktësisë së vetëdeklarimeve për llogaritjen dhe derdhjen e detyrimeve. Saktësimi i rezultatit financiar dhe fiskal të shoqërisë në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, Ligjit Nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligjit Nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore”, Ligjit Nr.9228, datë 30.01.2004 “Për kontabilitetin” si dhe udhëzimet e Ministrit të Financave në zbatim të tyre.

Kontrolli në këtë subjekt është realizuar në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr. ____ Prot., datë 17.05.2013, nga e cila rezulton se ky subjekt, ka ushtruar veprimtari të lidhura me subjektin “D” shpk, i cili sipas informacioneve që disponon Drejtoria e Hetimit Tatimor, është marrë me lëshimin e faturave fiktive të pashoqëruara me mall apo shërbim, gjë e cila ka sjellë një kreditim të padrejtë të TVSH-së, nga subjektet blerëse të këtyre faturave. Po në këtë shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është urdhëruar që për subjektin “K” shpk me NIPT ____, cili rezulton të jetë pjesë e këtyre transaksioneve me subjektin “D” shpk, për një vlerë totale 77.333.334 lekë, të mos i njihet kreditimi i këtyre faturave, duke ju llogaritur si detyrim tatimor.

Subjekti “K” shpk, ka ezauruar observacionet kundër projektit të raportit të kontrollit Nr. ____ datë 18.10.2013 të Drejtorisë Tatimore Durrës, me shkresën Nr. ____ prot., datë 18.10.2013, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga organi tatimor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pas shqyrtimit të Çështjes, me vendimin Nr. 241, datë 16.03.2016 ka vendosur pranimin e padisë pjesërisht. Konsatimin e pavlefshmërisë absolute vetëm për aktin Administrativ Nr. ____ Prot., datë 04.11.2013 dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Për këtë vendim është ushtruar ankim dhe nga paditësi dhe nga i padituri.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, dhe pasi mori shpjegimet dhe argumentet e tyre, konkludon se vlerësimi i gjykatës administrative të shkallës së parë Durrës, në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute për njërin nga njoftim vlerësimet është i pasaktë për faktin se po ti referohemi kërkesë padisë si dhe vetë pretendimeve të palës paditëse, rezulton se argumentat e paraqitura, nëpërmjet të cilave kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute, në fakt nuk lidhen me këtë të fundit, por lidhen me elementë të Pavlefshmërisë relative të një akti administrativ. Gjykata Administrative e Apelit, sikundër dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë një jurisprudencë shumë të konsoliduar në lidhje me këtë kategori çështjes. Kur nga pala kërkohet përpara gjykatës konstatimi i pavlefshmërisë absolute, gjykata limitohet, vetëm në vlerësimin e ekzistencës ose jo, të kushteve specifike dhe shëruese të parashikuara mbi pavlefshmërinë absolute, dhe nuk shqyrton themelin e çështjes, pasi kjo e fundit lidhet tërësisht me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ. Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit, konstaton se pranimi i pjesës së padisë nga Gjykata Administrative e shkallës së parë Durrës, duke marrë në konsideratë elemente të pavlefshmërisë relative, është një aplikim jo i drejtë i parashikimeve të Kodit të Procedurës administrative.

Vendimi i Gjykatës:

- Ndryshimin e Vendimit nr.241, datë 16.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
- Rrëzimin e Padisë me të gjitha kërkimet e saj.

6. Vendim nr. 1080, datë 23.12.2020

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: “I.R”

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë.

Objekti: Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr. _____, datë 10.01.2013.
Shfuqizim i vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr. _____, datë 24.04.2015.

Shuma e detyrimit tatimor: 120.000 lekë.

Baza Ligjore :

1. Neni 7,11 dhe 17 i ligjit ”Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative”
2. Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.
3. Ligji nr.1014 datë 28.09.2009 , Ligji nr.1020 datë 23.12.2009 , Ligji 1026 datë 01.04.2010.
4. Neni 47/1, nenet 93,115,116,117 dhe 118 të Kodit të Procedurave Administrative.

Përmbledhje e Fakteve:

Paditësi shoqëria I.R është në administrimin e DRT-së Durrës, në datën 03.10.2013 në këtë subjekt është ushtruar kontroll nga DRT ku është konstatuar se subjekti nuk ishte i pajisur me kasë fiskale dhe nuk dispononte librat e shitjes dhe të blerjes. Për këto shkelje është nxjerrë dhe Njoftim Vlerësimi nr. _____ datë 10.01.2013 me detyrimin në vlerën 120000 lekë.

Ky akt administrativ është ankimuar në DAT Tiranë nga tatimpaguesi dhe DAT Tiranë me vendimin nr. _____ prot. , datë 24.04.2015 ka refuzuar ankimin për tejkallim të afateve ligjore për të ushtruar të drejtën e ankimit duke arsyetuar se Njoftim Vlerësimi mban datën 10.01.2013 ndërsa ankimi është paraqitur në datën 24.03.2015 duke mos provuar pretendimet në lidhje me datën e marrjes dijeni për aktin apo për rivendosjen e tij në afat. Në këto rrethana pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Mbas njohjes me kërkesë padinë, pala e paditur i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për nxjerrje jashtë juridiksionit gjyqësor për mosrespektim afatesh, kërkesë kjo e cila është pranuar nga Gjykata me vendimin nr. 1286 datë 26.11.2015.

Pala paditëse ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim të vecantë në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë nga ana e saj ka konstatuar se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke urdhëruar vijimin e gjykimit. Gjithashtu pala paditëse ka saktësuar objektin e padisë duke kërkuar pavlefshmërinë relative të aktit administrativ.

Nga ana e saj, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, ka vendosur pranimin e pjesëshëm

të kërkesë padisë duke shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ nr. _____ datë 10.01.2013 duke lënë në fuqi dënimin administrativ në shumën 110000 lekë dhe duke rrëzuar pjesën tjetër të shumës objekt ankimi.

Më tej pala paditëse I.R, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr.509 datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Gjykata nga ana e saj me vendimin e datës 21.06.2016 , ka vendosur pranimin e ankimit pasi ka shqyrtuar elementët formal të tij.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit , ka arsyetuar se në lidhje me kushtet formale të pranueshmërisë së ankimit ndaj vendimit nr.509 datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, motivet e kërtimeve në kërkesë padi, parashtrimet e pretendimeve dhe kërkimet përfundimtare si dhe arsyetimit në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, vlerëson se egzistojnë kushtet e papranueshmërisë së ankimit referuar nenit 45 të ligjit 49/2012 “ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ku përcaktohen Vendimet e pankimueshme

Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt :

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Gjykata Administrative e Apelit ne dhome keshillimi vendosi :

Mospranimin e ankimit ne rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Vendim:

1. Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.509 datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Lënien në Fuqi të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë

7. Vendim nr. 267, datë 12.05.2021

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: Subjekti “O” SHPK,

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Objekti:

1. Konstatim si absolutisht i pavlefshem i aktit administrativ Njoftim Vlersimit nr.____, ____, ____, ____ prot., datë 24.06.2016 si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.
2. Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ

Shuma e detyrimit tatimor: 8,869,760 lekë

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedures Civile, neni 32, 153;
2. Kodi i Procedurave Administrative;
3. Ligji nr.49/2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmareveshjeve Administrative”;
4. Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
5. Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqëria “O” shpk është në administrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat. Me anë të Njoftim Vlerësimeve nr.____, _____,_____,_____ prot. datë 24.06.2016 dërguar nga DRT Berat, pala paditese është njohur me detyrimet e nxjerr nga Raporti i Kontrollit të kryer nga ana e drejtorisë.

Kontrolli filloi me 25.04.2016 dhe perfundoi me 06.05.2016 i cili kishte si objekt kontrolli:

- Kontroll ne lidhje me tvsh-ne per periudhen Maj 2014-Shkurt 2016.
- Kontroll ne lidhje me sakesimin e rezultatit financiare dhe tatimore per periudhat tatimore, viti, 2013, dhe 2014.
- Kontroll i derdhjes se kontributit te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe te ardhurave nga punësimi për periudhën, Maj 2014-Shkurt 2016.

Kontrolli u krye në bazë të:

- Njoftimit të kontrollit” nr. _____, datë 25.04.2016,

- Autorizimit për kryerje kontrolli” nr. _____, datë 25.04.2016, si dhe
- Programit të kontrollit bashkangjitur nr. _____, datë 25.04.2016.

Pala paditese e ka ankimuar aktin administrative për detyrimet tatimore Njoftim Vlersimit nr. _____, _____, _____, _____ prot. date 24.06.2016, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tirane, e cila me vendimin nr.25260 date 12.10.2016: ka vendosur:

- **Refuzimin e ankimit, për shkak se nuk është paguar detyrimi tatimor i përcaktuar në aktin administrative objekt ankimi Baza Ligje**

Pas marrjes së refuzimit nga DAT pala paditese i është drejtuar me kerkese padi, me objekt “Konstatim i pavlefshmerisë absolute” Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin nr.308, datë 28.02.2017 ka vendosur :

- *Rrëzimin e kerkese Padise sit e pabazuar në prova e në ligj....*

Vlerësimi i Gjykatës:

Shoqëria “O” shpk, e ka ankimuar vendimin nr.308, date 28.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore, në Gjykatën Administrative të Apelit e cila vlerëson se:

Si kriter kryesor për të dalluar pavlefshmerinë absolute nga relative merret shkalla e shkeljes së ligjit, rrezikshmeria e aktit të shkelur, shkalla e mundësisë së eliminimit të shkeljes nga vetë organi që e ka nxjerrë aktin, etj.

Tre janë rastet që ligji ka parashikuar për të kuptuar që një akt është absolutisht i pavlefshëm:

1. Rasti i parë lidhet me ato akte që janë nxjerrë nga një organ administrative i paidentifikuar dhe që nuk njihet si i till
2. Rasti i dytë i pavlefshmerisë absolute ka të bëjë me aktet administrative që nxirren nga një organ administrative në kapercim të kufijëve të kompetencave të tij.
3. Rasti i tretë lidhet me shkeljet në mënyrë flagrante të formës dhe procedurës së nxjerrjes së aktit administrative.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, në lidhje me rastin konkret, pretendimet e palës paditëse për pavlefshmëri absolute të akteve administrative janë pretendime të pabazuara në ligj dhe në prova e si të tilla të papranueshme.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se veprimet e kryera nga DRT Berat janë brenda kompetencave të ushtrimit të detyrave funksionale ligjore sipas ligjit nr.9920/2008

Sipas vlersimit të Gjykatës Administrative të Apelit, pala paditese nuk ka ngritur një shkak thelbësor që ka të bëjë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe njëkohësisht shkaqet e ngritura nuk i referohen ndonjë shkelje procedurale që të pas sjellë cënimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.308, datë 28.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

8. Vendim nr.269, datë 12.05.2021

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria tregtare “I” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti: Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. _____ prot., datë 26.04.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 1,695,000 lekë.
Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. _____ prot., datë 07.07.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore: 1,695,000 lekë në total për periudhën 2015/09, 2015/11.

Baza Ligjore:

1. Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 109.
2. Udhëzimi nr.19 datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, neni 9, 10;
3. Kodi i Procedurave Civile, nenet 154 e vijues.
4. Kodi i Procedurave Administrative neni 108;

Përmbledhje e fakteve:

Tatimpaguesi “I”sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesëpadinë me objekt:

1. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. _____ prot datë 26.04.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën 1,695,000 lekë.
2. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. _____ prot datë 07.07.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Ky akt administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ prot datë 26.04.2016 është nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në Aktin e Rivlerësimit “Për Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së” nr. _____ prot datë 12.12.2015 i mbajtur nga inspektori i Drejtorisë së vlerësimit në DRT Sarandë. Ky akt rivlerësimi ka nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për tatimpaguesin ‘I’ sh.p.k, pasi ky tatimpagues ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 8 pika 4 të UMF nr.19 datë 03.11.2014 ‘Për zbatimin e regjimit të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar’.

Konkretisht ky tatimpagues, i cili është aplikues i skemës së kompensimit të fermerëve, nuk e ka

njoftuar DRT Sarandë për Akt-Marrëveshjet e lidhura me 4 (katër) fermerë, përpara se të fillonte aplikimin e skemës së kompensimit dhe ka zbritur TVSH-në si normë e kompensimit të shënuar në faturat e lëshuara në emër të fermerëve.

Për këtë procedurë të kryer në kundërshtim me dispozitën ligjore, nga ana e DRT Sarandë i janë nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për periudhën Shtator 2015 në shumën 1,175,000 lekë dhe për periudhën Nëntor 2015 në shumën 520,000 lekë. Në total i është nxjerrë detyrimin në shumën 1,695,000 lekë.

Tatimpaguesi "I" sh.p.k, ka ankimuar në DAT Tiranë aktin administrativ të nxjerrë nga DRT Sarandë e konkretisht Njoftim Vlerësimin nr. _____ prot datë 26.04.2016. DAT Tiranë me vendimin e saj nr. _____ prot., datë 07.07.2016, ka vendosur: *Refuzimin e ankimit ndaj njoftim vlerësimit nr. _____ prot datë 26.04.2016, nxjerrë nga DRT Sarandë, për shkak se nuk është paguar dhe nuk është vënë garanci bankare për detyrimin tatimor të përcaktuar në aktin administrative të ankimuar.*

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar deklarin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. _____ prot., datë 26.04.2016, për pagesën e tvsh-së në shumën 1,695,000 lekë.

2. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. _____ prot datë 07.07.2016 të DAT-së.

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin e saj nr.724 datë 17.11.2016 ka vendosur:

Pranimin e padisë: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. _____ prot., datë 26.04.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe pavlefshmërinë e vendimit nr. _____ prot., datë 07.07.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRT Sarandë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative dhe me vendimin e saj nr.269 datë 12.05.2021 ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Kjo gjykatë ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së parë Gjirokastër ka dalë në konkluzione të gabuara që nuk merr parasysh faktin se në aktin administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ prot., data e vendosur në këtë akt është data 14.12.2015, pra akti administrativ është nxjerrë dy ditë pasi është mbajtur Akt-Rivlerësimi nr. _____ prot datë 12.12.2015, i cili i është njoftuar palës paditëse së pari në rrugë elektronike në faqen personale të këtij subjekti. Data tjetër e vendosur në këtë akt është data 26.04.2016 dhe është data kur është tërhequr akti nga pala paditëse pranë DRT Sarandë.

Sistemi i ri tatimor c@ts bën të mundur hedhjen e të gjitha dokumentave që kanë lidhje me tatimpaguesit online dhe të gjitha aktet e shkresat që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore të subjekteve, në faqet e tyre personale elektronike.

Gjithashtu Kolegji konstaton se pala e paditur ka ndjekur procedurën në zbatim të nenit 23 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 'Për Procedurat Tatimore në R.SH', i ndryshuar.

Akti administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor është nxjerrë në respektim të formës dhe procedurës së kërkuar sipas nenit 68 pika 1 gërma a dhe nenit 69 pika 2 të Ligjit 9920/2008 ‘Për Proçedurat Tatimore në R.SH’, i ndryshuar.

Po kështu Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ prot datë 26.04.2016 i nxjerrë nga DRT Sarandë, është nënshkruar nga Drejtori Rajonal dhe vulosur me vulën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, që përmban të gjithë elementët e domosdoshëm që parashikon Kodi i Proçedurave Administrative për një akt administrativ.

Kolegji vlerëson se pretendimi se akti administrativ objekt ankimi është nxjerrë jashtë afatit të përcaktuar ligjor, është i gabuar për faktin se palës paditëse i janë komunikuar vlerësimet dhe komunikimet zyrtare së pari në rrugë elektronike si e kërkon ligji dhe më pas janë tërhequr nga pala paditëse pranë DRT Sarandë.

Përsa i përket arsytimit tjetër të gjykatës së shkallës së parë se ky akt është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga neni 46 i ligjit nr.10433 ‘për Inspektimin’, Kolegji vlerëson se ky ligj nuk gjen zbatim në rastin konkret. Pra ligji për inspektimin nuk i shtrin efektet e veta dhe nuk gjen zbatim në kryerjen e proçedurave ligjore që ndjek organi tatimor gjatë detyrave funksionale që kryen. Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se Njoftim Vlerësimi nr. _____ prot datë 26.04.2016 nuk përfshihet në asnjë nga rastet e pavlefshmërisë absolute të parashikuar nga neni 108 i Ligjit nr.44/2015 i K.Pr.Administrative, përkundrazi ai ka dalë në zbatim të Ligjit nr.9920/2008 ‘Për Proçedurat Tatimore në R.SH’, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.19 datë 03.11.2014 ‘Për Zbatimin e Regjimit të Veçantë të Skemës së Kompensimit të Prodhuesve Bujqësorë për Qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”.

Konkretisht, shkak i penalizimit të palës paditëse janë bërë verifikimi i blerjeve të subjektit të mësipërm për muajt shtator 2015 dhe nëntor 2015.

Bazuar në të dhënat e regjistrit të fermerëve pranë DRT Sarandë, rezulton se ky tatimpagues nuk ka njoftuar DRT Sarandë dhe nuk ka depozituar akt-marrëveshjet me fermerët e deklaruar në librin e blerjeve për periudhën Shtator 2015, Nëntor 2015, përpara se të fillonte aplikimin e skemës së kompensimit të fermerit.

Për këtë shkelje të konstatuar, DRT Sarandë ka mbajtur aktin e rivlerësimit përkatës dhe ka nxjerrë njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. _____ prot., datë 26.04.2016, çka do të thotë se rivlerësimi i kryer për palën paditëse është kryer në respektim të ligjit, pasi ky subjekt nuk ka depozituar pranë DRT Sarandë akt-marrëveshjet e lidhura me fermerët përpara se të fillonte të aplikonte skemën e kompensimit.

Kolegji vlerëson gjithashtu se me të drejtë Drejtoria e Apelit Tatimor ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi pala paditëse nuk ka parapaguar detyrimin tatimor që ankimohet ose nuk ka vendosur garanci bankare, në respektim të nenit 107 të ligjit 9920/2008 ‘Për proçedurat tatimore në R.SH’, i ndryshuar.

Përfundimisht Kolegji vlerëson se dhe vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. _____ prot., datë 07.07.2016 është një vendim i dhënë në respektim të ligjit dhe nuk ka asnjë element të pavlefshmërisë absolute.

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar dhe në ankimin e palës së paditur dhe pretendimet e paraqitura prej saj, arrin në konkluzionin se ka shkaqe që diktojnë ndryshimin e vendimit të shkallës së parë.

Vendimi i Gjykatës:

1. Ndryshimin e vendimit nr.724 datë 17.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Rrëzimin e kërkesë padisë.